



RAPORT MONITORIMI

PLANI I INTEGRITETIT

BASHKITË SHIJAK DHE PËRMET

TIRANË 2026

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Metodologjia	5
Qasja Vlerësuese për Bashkinë Përmet	7
Qasja Vlerësuese për Bashkinë Shijak	9
Qëllimi dhe shtrirja e Planeve të Integritetit	11
Objektivat kryesore të Planeve	14
Logjika e monitorimit	18
Analiza e transparencës dhe komunikimit publik	21
Programi i Transparencës dhe rubrikat për informim	23
Koordinatori për të drejtën e informimit dhe koherenca e të dhënave.....	26
Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes në Bashkinë Përmet.....	29
Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes në Bashkinë Shijak	31
Gjetjet e Monitorimit për Bashkinë Përmet.....	36

Gjetjet e Monitorimit për Bashkinë Shijak.....	42
Konkluzione	48
Rekomandime.....	50
Bibliografia	53

HYRJE

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit përbëjnë një ndër prioritetet kryesore të qeverisjes publike në Shqipëri, veçanërisht në nivelin e pushtetit vendor, ku ofrohen shërbime të drejtpërdrejta për qytetarët¹. Në këtë kuadër, integriteti nënkupton ushtrimin e funksioneve administrative dhe rregullatore në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitë.

Në funksion të forcimit të këtyre parimeve, Qendra CEDI, me mbështetjen e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), po zbaton projektin “Lufta kundër korrupsionit: ti mund të kontribuosh!”, i cili synon rritjen e integritetit dhe përmirësimin e praktikave të qeverisjes në nivel vendor.

1) Kuvendi i Shqipërisë, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (Tiranë, 2015)

Bashkia Përmet, Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 6 Datë 31.01.2022 (Përmet, 2022), <https://bashkiapermet.gov.al/?s=planiintegritetit>
Bashkia Shijak, Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 20 Datë 07.06.2022 (Shijak 2022), <https://www.shijak.gov.al/?s=planiintegritetit>

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit të Bashkia Përmet² dhe Bashkia Shijak³ gjatë vitit 2025, në kuadër të dokumentave politike përkatëse 2022–2025, të miratuara nga këshillat bashkiakë respektivë. Monitorimi është realizuar në funksion të vlerësimit të progresit të arritur në zbatimin e masave të parashikuara, si dhe për identifikimin e sfidave dhe problematikave që ndikojnë në funksionimin efektiv të sistemit të integritetit institucional.

Raporti synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të masave të parashikuara në planet e integritetit, të evidentojë mangësitë dhe sfidat e hasura gjatë periudhës së monitorimit, si dhe të identifikojë praktikrat pozitive që kontribuojnë në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe besimit publik në këto institucione.

Metodologjia e përdorur mbështetet në qasjen e Ministrisë së Drejtësisë për monitorimin e Planeve të Integritetit⁴ dhe kombinon analiza cilësore dhe sasiore, të bazuara në të dhëna të verifikueshme dhe burime zyrtare informacioni.

Gjetjet e këtij raporti synojnë të shërbejnë si bazë për ndërmarrjen e masave përmirësuese dhe për orientimin e veprimeve të ardhshme institucionale në drejtim të forcimit të integritetit dhe parandalimit të korrupsionit në nivel vendor.

2) Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 6 Datë 31.01.2022

3) Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 20 Datë 07.06.2022

4) Ministria e Drejtësisë – Baza ligjore dhe dokumente

METODOLOGJIA

Monitorimi i zbatimit të Planeve të Integritetit është realizuar përmes një qasjeje të kombinuar metodologjike, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe strukturën e vetë planit të integritetit.

Metodat cilësore kanë përfshirë analizën e kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional të bashkive, duke përfshirë shqyrtimin e dokumenteve strategjike, rregulloreve të brendshme, procedurave standarde të veprimit dhe akteve administrative. Gjithashtu, është analizuar mënyra e funksionimit të praktikave institucionale në lidhje me etikën, transparencën dhe menaxhimin e riskut të integritetit, në përputhje me fushat funksionale të parashikuara në planet respektive.

Ndërkohë, metodat sasiore janë përdorur për të vlerësuar nivelin e zbatimit të masave të Planeve të Integritetit⁵, përmes klasifikimit të tyre sipas statusit të zbatimit (të realizuara, në proces dhe të parealizuara), analizës së të dhënave të

5) Bashkia Përmet, Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 6 Datë 31.01.2022(Përmet, 2022), <https://bashkiapermet.gov.al/?s=paniiintegritetit>

Bashkia Shijak, Vendimi Këshillit Bashkiak Nr. 20 Datë 07.06.2022(Shijak 2022), <https://www.shijak.gov.al/?s=paniiintegrtetit>

raportuara nga strukturat përgjegjëse, si dhe verifikimit të informacionit të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë, në kuadër të Programit të Transparencës.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave është realizuar gjatë një periudhe pesëmuajore, përmes konsultimit të burimeve publike dhe komunikimit me strukturat përkatëse të bashkive. Analiza është kryer në mënyrë krahasuese, duke vlerësuar progresin e arritur në raport me objektivat, afatet dhe masat e parashikuara në Planet e Integritetit.

Është krahasuar zbatimi i masave me planifikimin për periudhën shtator–dhjetor, për të vlerësuar progresin dhe identifikuar mangësitë.

QASJA VLERËSUESE PËR BASHKINË PËRMET

Qasja vlerësuese e këtij monitorimi është ndërtuar mbi parimet e objektivitetit, gjithëpërfshirjes dhe transparencës, duke u mbështetur në logjikën e menaxhimit të riskut dhe të forcimit të integritetit institucional, siç parashikohet në Planin e Integritetit të Bashkia Përmet.

Procesi i vlerësimit është konceptuar si një analizë e strukturuar dhe sistematike, e orientuar drejt matjes së nivelit të zbatimit të masave të planifikuara në Planin e Integritetit, si dhe drejt vlerësimit të funksionimit real të mekanizmave institucionale për parandalimin dhe menaxhimin e risqeve të integritetit. Në këtë kuadër, janë marrë në konsideratë karakteristikat e kontekstit institucional të bashkisë, kapacitetet organizative dhe burimet njerëzore dhe teknike në dispozicion, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zbatimin e planit.

Vlerësimi është përqendruar në analizimin e shkallës së realizimit të masave për secilin objektiv të Planit të Integritetit⁶, duke evidentuar nëse këto masa janë zbatuar, janë në

6) Bashkia Përmet, Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 6 Datë 31.01.2022

proces apo kanë mbetur të parealizuara. Paralelisht, është analizuar funksionimi praktik i mekanizmave të parashikuar për parandalimin dhe menaxhimin e risqeve të integritetit, si dhe përputhshmëria e veprimeve institucionale me kuadrin rregullator dhe procedurat e brendshme të bashkisë.

Një element i rëndësishëm i vlerësimit ka qenë edhe analiza e nivelit të transparencës⁷ institucionale, përmes verifikimit të informacionit të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë, në përputhje me kërkesat e Programit të Transparencës dhe detyrimet ligjore për informimin publik. Në të njëjtën kohë, është vlerësuar niveli i ndërgjegjësimit dhe angazhimit të strukturave administrative në zbatimin e planit, duke marrë parasysh rolin e tyre në funksionimin efektiv të sistemit të integritetit.

E gjithë analiza është bazuar në evidenca konkrete dhe në krahasimin ndërmjet masave të planifikuara dhe zbatimit të tyre në praktikë, çka ka mundësuar një vlerësim më të plotë të progresit të arritur, si dhe identifikimin e mangësive dhe sfidave që ndikojnë në efektivitetin e Planit të Integritetit.

Vlerësimi është realizuar në nivel institucional dhe sistemik, pa u fokusuar në performancën individuale të punonjësve. Kjo qasje synon të kontribuojë në forcimin e mekanizmave të brendshëm të integritetit, përmirësimin e proceseve të punës dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të integritetit në Bashkinë Përmet.

7) Bashkia Përmet, "Transparenca," <https://bashkiapermet.gov.al/transparenca/>

QASJA VLERËSUESE PËR BASHKINË SHIJAK

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkia Shijak është ndërtuar mbi një qasje institucionale dhe parandaluese, e cila fokusohet në funksionimin e mekanizmave të integritetit në nivel organizativ dhe jo në vlerësimin individual të punonjësve. Kjo qasje është në përputhje me qëllimin e planit të integritetit⁸, i cili synon përmirësimin e praktikave institucionale dhe forcimin e mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies.

Në këtë kuadër, vlerësimi është përqendruar në analizimin e nivelit të zbatimit të masave të parashikuara në plan, në raport me objektivat e përcaktuara për fushat kryesore të veprimtarisë së bashkisë. Njëkohësisht, është analizuar mënyra se si këto masa reflektohen në praktikën institucionale, veçanërisht në drejtim të transparencës⁹, llogaridhënies¹⁰ dhe respektimit të standardeve etike.

8) Bashkia Shijak, “Plani i Integritetit,” <https://www.shijak.gov.al/?s=pani+i+integrtetit>

9) Bashkia Shijak, “Transparenca,” <https://www.shijak.gov.al/?s=transparenca>.

10) Bashkia Shijak, “TransparencadheLlogaridhëniaEkonomiko-Financiare,” <https://www.shijak.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomiko-financiare/>

Vëmendje e veçantë i është kushtuar identifikimit të risqeve të vazhdueshme të integritetit dhe mënyrës se si ato adresohen nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me masat e parashikuara në plan. Gjithashtu, është vlerësuar niveli i kapaciteteve administrative dhe organizative të bashkisë për zbatimin e Planit të Integritetit, duke marrë në konsideratë burimet në dispozicion dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e tij.

Kjo qasje ka mundësuar një vlerësim të përgjithshëm të progresit të arritur në zbatimin e planit, si dhe identifikimin e sfidave dhe nevojave për përmirësim në funksion të forcimit të integritetit institucional në Bashkinë Shijak.

QËLLIMI DHE SHTRIRJA E PLANEVE TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit i Bashkisë Përmet për periudhën 2022–2025 përbën një dokument strategjik dhe operacional, i hartuar mbi bazën e një procesi të strukturuar të vlerësimit të riskut të integritetit në nivel bashkie. Ky plan synon të vendosë në funksionim një sistem të qëndrueshëm dhe të mirëorganizuar të menaxhimit të integritetit institucional, duke identifikuar risqet kryesore që lidhen me ushtrimin e funksioneve të bashkisë dhe duke parashikuar masa konkrete për zbutjen apo eliminimin e tyre¹¹.

Në përmbajtjen e tij, plani i kushton rëndësi të veçantë analizës së cenueshmërisë së integritetit në nivel procesesh pune, duke u fokusuar në fushat funksionale më të ekspozuara ndaj riskut. Konkretisht, vlerësimi i riskut është shtrirë në fusha të tilla si *menaxhimi financiar, menaxhimi i burimeve njerëzore, mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe auditimit, shërbimet publike, administrimi dhe menaxhimi i pronave, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, si dhe arkivimi dhe administrimi i doku-*

11) BashkiaPërmet ,VendimiKëshillitBashkiak Nr. 6, datë 31.01.2022: PlaniIntegritetit, 31 January 2022, f. 11.

menteve dhe informacionit. Kjo qasje e detajuar tregon një orientim të qartë drejt analizës sistematike të proceseve dhe identifikimit të pikave të dobëta që mund të cenojnë integritetin institucional.

Nga ana tjetër, Plani i Integritetit i Bashkisë Shijak është gjithashtu hartuar mbi bazën e vlerësimit të riskut të integritetit në nivel vendor dhe synon forcimin e mekanizmave për parandalimin, identifikimin dhe adresimin e risqeve që mund të ndikojnë në integritetin institucional dhe besimin e publikut në qeverisjen vendore. Në krahasim me Bashkinë Përmet, plani i Bashkisë Shijak paraqitet më i përmbledhur në analizën e riskut, por ruan të njëjtën logjikë të ndërhyrjes përmes masave konkrete në fusha kyçe të veprimtarisë së bashkisë.

Vlerësimi i riskut në këtë plan është shtrirë në disa fusha të rëndësishme të funksionimit institucional, duke përfshirë *menaxhimin e pronave dhe planifikimin e territorit, menaxhimin financiar dhe mekanizmat e kontrollit, kuadrin rregullator dhe respektimin e standardeve etike, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe ofrimin e shërbimeve publike, si dhe transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut.* Këto fusha përfaqësojnë dimensionet kryesore ku mund të shfaqen risqet e integritetit dhe ku kërkohet ndërhyrje e vazhdueshme institucionale.

Në tërësi, të dy planet e integritetit reflektojnë një qasje të bazuar në menaxhimin e riskut dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale, megjithatë, ato dallojnë në nivelin e detajimit

dhe thellësisë së analizës, duke e bërë planin e Bashkisë Përmet më të strukturuar dhe analitik, ndërsa atë të Bashkisë Shijak më të përqendruar në aspektin praktik të zbatimit të masave.

OBJEKTIVAT KRYESORE TË PLANEVE

Plani i Integritetit i **Bashkia Përmet**¹² organizohet rreth tre objektivave kryesorë, të cilët përfaqësojnë shtyllat themelore të sistemit të menaxhimit të integritetit institucional . Këto objektiva janë të ndërtuara mbi një qasje të bazuar në menaxhimin e riskut dhe synojnë të adresojnë në mënyrë të integruar dobësitë strukturore dhe operationale të bashkisë.

Objektivi i parë lidhet me forcimin, menaxhimin efektiv dhe zhvillimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore, duke synuar rritjen e kapaciteteve profesionale dhe etike të stafit. Ky objektivi reflekton rëndësinë që plani i jep burimeve njerëzore si një element kyç në parandalimin dhe identifikimin e risqeve të integritetit në të gjitha nivelet e administratës. Në këtë kuadër, parashikohen masa që lidhen me plotësimin e vakancave, rritjen e kapaciteteve teknike, përmirësimin e proceseve të vlerësimit dhe zhvillimit profesional, si dhe forcimin e rolit të strukturave përgjegjëse për menaxhimin e personelit.

12) Bashkia Përmet, PlaniiIntegritetit 2022–2025 (Përmet, 2022), <https://bashkiapermet.gov.al/?s=planiintegritetit>

Objektivi i dytë fokusohet në menaxhimin e riskut të integritetit në të gjithë bashkinë, me theks të veçantë në fusha të caktuara të përgjegjësisë, si menaxhimi financiar, administrimi i pronave, prokurimet publike, shërbimet publike dhe planifikimi i territorit. Ky objektiv përfaqëson dimensionin më operacional të planit, pasi përfshin identifikimin e risqeve konkrete dhe përcaktimin e masave specifike për adresimin e tyre. Ai lidhet drejtpërdrejt me funksionimin e proceseve të përditshme të bashkisë dhe kërkon një nivel të lartë koordinimi ndërmjet strukturave përkatëse.

Objektivi i tretë ka në fokus forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e etikës dhe integritetit, përmes hartimit, përditësimit dhe zbatimit të rregullave dhe procedurave të qarta. Një element i rëndësishëm i këtij objektivi është edhe publikimi i këtyre dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë, në kuadër të Programit të Transparencës, duke synuar rritjen e aksesit të publikut në informacion dhe përmirësimin e llogaridhënies institucionale. Kjo tregon një lidhje të drejtpërdrejtë midis planit të integritetit dhe praktikave të transparencës së bashkisë.

Ndërkohë, Plani i Integritetit i **Bashkisë Shijak**¹³ është strukturuar rreth pesë objektivave kryesorë, duke reflektuar një qasje më të shpërndarë sipas fushave funksionale të veprimtarisë së bashkisë . Këto objektiva synojnë të adresojnë risqet

13) Bashkia Shijak, Plani i Integritetit 2022–2025 (Shijak, 2022)

e integritetit në mënyrë më të drejtpërdrejtë në secilën fushë kryesore.

Objektivat e parë dhe të dytë lidhen me përmirësimin e procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fusha specifike, si administrimi i pronave dhe planifikimi i territorit, si dhe menaxhimi financiar dhe mekanizmat e kontrollit. Këto fusha konsiderohen ndër më të ekspozuarat ndaj risqeve të integritetit dhe kërkojnë masa të dedikuara për rritjen e kontrollit dhe transparencës.

Objekti i tretë fokusohet në forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e etikës dhe integritetit, duke synuar krijimin e një baze të qartë rregullash dhe procedurash për funksionimin institucional. Ky objektiv është i ngjashëm me atë të Bashkisë Përmet, por në rastin e Shijakut paraqitet si një komponent më i drejtpërdrejtë dhe më i përqendruar.

Objekti i katërt lidhet me forcimin e integritetit institucional përmes menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, si dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike. Kjo tregon një ndërthurje midis dimensionit të brendshëm organizativ dhe ndikimit të tij në shërbimet që i ofrohen qytetarëve.

Objekti i pestë ka në fokus forcimin e transparencës dhe llogaridhënies publike, me qëllim rritjen e besimit të qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Ky objektiv reflektohet edhe në rëndësinë që i jepet publikimit të

informacionit në faqen zyrtare të bashkisë dhe komunikimit me publikun.

Në tërësi, ndërsa Plani i Integritetit i Bashkisë Përmet paraqet një strukturë më të përqendruar dhe analitike, i organizuar në tre objektiva të gjerë që mbulojnë në mënyrë të integruar të gjitha fushat, Plani i Bashkisë Shijak ndjek një qasje më të fragmentuar sipas fushave specifike, duke e bërë më të drejtpërdrejtë lidhjen ndërmjet objektivave dhe funksioneve konkrete të bashkisë.

LOGJIKA E MONITORIMIT

Monitorimi për vitin 2025 është konceptuar si një fazë e ndërmjetme e zbatimit të Planeve të Integritetit dhe synon të ofrojë një pasqyrë të progresit të arritur në raport me objektivat dhe masat e parashikuara, pa qenë ende një vlerësim përfundimtar i ciklit të plotë të planit. Kjo fazë e ndërmjetme lejon identifikimin e tendencave të zbatimit, evidentimin e sfidave dhe vlerësimin e nivelit të institucionalizimit të mekanizmave të integritetit.

Në këtë kuadër, monitorimi është fokusuar në disa kategori kryesore masash.

Së pari, janë vlerësuar masat që duhet të konsiderohen të konsoliduara në këtë fazë të zbatimit, të tilla si ekzistenca dhe funksionimi i mekanizmave bazë të integritetit, miratimi dhe publikimi i rregulloreve të brendshme, si dhe funksionimi i strukturave kyçe përgjegjëse për transparencën dhe llogaridhënien. Këto elemente përbëjnë bazën institucionale mbi të cilën ndërtohet sistemi i integritetit dhe pritet të jenë tashmë funksionale.

Së dyti, vëmendje i është kushtuar masave me karakter të vazhdueshëm, të cilat kërkojnë zbatim periodik dhe të qëndrueshëm në kohë, si publikimi i informacionit në faqen zyrtare, realizimi i proceseve të konsultimit publik, mirëmbajtja e regjistrave administrative dhe raportimet e brendshme institucionale. Vlerësimi i këtyre masave është orientuar drejt verifikimit të rregullsisë, konsistencës dhe vazhdimësisë së tyre në praktikë.

Së treti, janë analizuar masat që kërkojnë progres të dokumentuar, të tilla si zhvillimi i trajnimeve për stafin, krijimi ose forcimi i strukturave të reja organizative, si dhe rishikimi apo përditësimi i kuadrit rregullator të brendshëm. Për këto masa, vlerësimi është bazuar në ekzistencën e evidencave konkrete që dëshmojnë ndërmarrjen e hapave për zbatimin e tyre.

Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e masave të Planit të Integritetit kërkon evidenca të brendshme institucionale, si urdhra, vendime, raporte të njësive administrative apo dokumentacion mbështetës, ky monitorim është mbështetur kryesisht në burime të aksesueshme publikisht. Në këtë kuadër, vlerësimi është orientuar në analizën e evidencës publike, përfshirë dokumentet dhe informacionin e publikuar në faqen zyrtare të bashkisë, si dhe në identifikimin e gjurmëve administrative që mund të verifikohen përmes mekanizmave të së drejtës për informim.

Gjithashtu, një element i rëndësishëm i vlerësimit ka qenë analiza e koherencës institucionale, duke vlerësuar nëse ekziston përputhshmëri ndërmjet dokumenteve të publikuara, strukturës organizative dhe funksionimit praktik të bashkisë. Kjo përfshin elementë si përditësimi i informacionit, qartësia e roleve dhe përgjegjësi, si dhe aksesueshmëria e dokumenteve për publikun.

Në tërësi, kjo qasje ka mundësuar një vlerësim realist dhe të balancuar të nivelit të zbatimit të Planit të Integritetit në këtë fazë të ndërmjetme, duke evidentuar jo vetëm progresin e arritur, por edhe boshllëqet që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme institucionale.

ANALIZA E TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT PUBLIK (BAZUAR NË BURIME PUBLIKE)

Gjatë periudhës së monitorimit, një pjesë e rëndësishme e vlerësimit është fokusuar në praninë, cilësinë dhe aksesueshmërinë e informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, si një element kyç i integritetit institucional dhe i zbatimit të Planit të Integritetit .

Në këtë kuadër, është analizuar nëse bashkia siguron publikimin e informacionit në përputhje me detyrimet ligjore dhe me kërkesat e Programit të Transparencës¹⁴, si dhe nëse informacioni i publikuar është i plotë, i përditësuar dhe lehtësisht i aksesueshëm për qytetarët. Vëmendje e veçantë i është kushtuar kategorive kryesore të informacionit që lidhen me integritetin institucional, të tilla si publikimi i rregulloreve të brendshme, vendimeve të Këshillit Bashkiak, dokumenteve strategjike, procedurave administrative dhe informacioneve mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë.

14) Bashkia Përmet, "Transparenca,", <https://bashkiapermet.gov.al/transparenca/>

Gjithashtu, është vlerësuar niveli i transparencës në lidhje me proceset vendimmarrëse, duke analizuar nëse bashkia ofron informacion mbi konsultimet publike, njoftimet për qytetarët dhe rezultatet e këtyre proceseve. Kjo lidhet drejtpërdrejt me masat e parashikuara në Planin e Integritetit, të cilat synojnë rritjen e pjesëmarrjes së publikut dhe përmirësimin e komunikimit institucional.

Një tjetër element i analizës ka qenë vlerësimi i vazhdimësisë së publikimeve, duke shqyrtuar nëse informacioni publikohet në mënyrë periodike dhe nëse reflekton zhvillimet aktuale të bashkisë. Në këtë drejtim, është analizuar konsistenca e përditësimit të seksioneve kryesore të faqes, si dhe prania e informacionit të kohëve të fundit në raport me periudhën e monitorimit.

Përveç përmbajtjes, është marrë në konsideratë edhe aspekti funksional i faqes zyrtare, përfshirë strukturimin e informacionit, lehtësinë e navigimit dhe aksesin në dokumente, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në transparencën efektive dhe në mundësinë e qytetarëve për të marrë informacion në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

Në tërësi, analiza e transparencës dhe komunikimit publik¹⁵ ka shërbyer si një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të zbatimit të masave të integritetit, duke reflektuar shkallën e hapjes institucionale dhe angazhimit të bashkisë për të garantuar informimin dhe përfshirjen e publikut në proceset e saj.

15) Bashkia Shijak, "Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve," Transparenca, <https://www.shijak.gov.al/>

PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE RUBRIKAT PËR INFORMIM

Bashkia Përmet ka të publikuar në faqen e saj zyrtare rubrika të posaçme që lidhen me transparencën dhe informimin e publikut¹⁶, duke përfshirë Programin e Transparencës dhe nën-seksione të dedikuara për të drejtën e informimit, dokumentet e kërkuara më shpesh dhe informacionet bazë për funksionimin e institucionit. Prania e këtyre rubrikave përbën një element të rëndësishëm për garantimin e transparencës institucionale dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për informimin publik.

Nga analiza e përmbajtjes së publikuar, rezulton se Programi i Transparencës shërben si një instrument orientues për qytetarët, duke ofruar informacion mbi kategoritë e dokumenteve që duhet të jenë të aksesueshme pa kërkesë, si dhe mbi procedurat për paraqitjen e kërkesave për informacion¹⁷. Kjo

16) Bashkia Shijak, faqja zyrtare, seksioni transparenca, regjistri i kërkesa dhe përgjigjeve

17) Bashkia Përmet, "Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve," Transparenca, <https://bashkiapermet.gov.al/n>
Bashkia Përmet, "Kërkesa për Informacion," <https://bashkiapermet.gov.al/>

është në përputhje edhe me masat e parashikuara në Planin e Integritetit, i cili thekson rëndësinë e publikimit të dokumenteve dhe rritjes së aksesit të publikut në informacion si pjesë e forcimit të integritetit institucional.

Megjithatë, përtej ekzistencës së këtyre rubrikave, një element thelbësor i vlerësimit lidhet me cilësinë dhe përditësimin e informacionit të publikuar, si dhe me lehtësinë e aksesit për përdoruesit. Në këtë drejtim, vlerësimi i efektivitetit të Programit të Transparencës lidhet jo vetëm me praninë formale të tij në faqe, por edhe me mënyrën se si ai zbatohet në praktikë përmes publikimeve të rregullta dhe të strukturuar.

Nga ana tjetër, analiza e faqes zyrtare të **Bashkisë Shijak** tregon se bashkia ka të publikuar Programin e Transparencës, dokumente të rëndësishme vendimmarrëse, njoftime për konsultime publike¹⁸ dhe informacion në lidhje me procedurat për ushtrimin e së drejtës për informim . Këto elemente përbëjnë baza të rëndësishme për garantimin e aksesit të publikut në informacion dhe për përmbushjen e standardeve minimale të transparencës institucionale.

Në veçanti, publikimi i dokumenteve vendimmarrëse dhe i njoftimeve për konsultime publike kontribuon në rritjen e llogaridhënies dhe në përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Gjithashtu, prania e informacionit mbi të drejtën e

18) Bashkia Shijak, "Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve," Transparenca, <https://www.shijak.gov.al/>

informimit lehtëson komunikimin ndërmjet qytetarëve dhe institucionit, duke krijuar mundësi për kërkimin dhe marrjen e informacionit në mënyrë të strukturuar.

Në tërësi, të dy bashkitë paraqesin një bazë funksionale të rubrikave të transparencës në faqet e tyre zyrtare, megjithatë niveli i efektivitetit të tyre lidhet drejtpërdrejt me përditësimin, plotësinë dhe aksesueshmërinë e informacionit të publikuar, si dhe me mënyrën se si këto mekanizma përdoren në praktikë për të garantuar transparencë reale dhe jo vetëm formale.

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE KOHERENCA E TË DHËNAVE

Në faqen zyrtare të **Bashkisë Përmet** rezultojnë të publikuara seksione të dedikuara për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit¹⁹, të cilat përbëjnë një element thelbësor për garantimin e aksesit të qytetarëve në informacion, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe me kërkesat e Programit të Transparencës .

Megjithatë, gjatë analizës është konstatuar një mospërputhje në të dhënat e publikuara në faqe të ndryshme, konkretisht në lidhje me emrin dhe kontaktet e Koordinatorit. Kjo mospërputhje krijon paqartësi për qytetarët dhe mund të ndikojë negativisht në ushtrimin efektiv të së drejtës për informim, pasi vështirëson identifikimin e kontaktit zyrtar përgjegjës për trajtimin e kërkesave për informacion.

Nga këndvështrimi i integritetit institucional, kjo situatë reflekton një mungesë koherence në menaxhimin dhe publikimin e

19) Bashkia Përmet, “Koordinatoripërtë Drejtën e Informimit,”<https://bashkiapermet.gov.al/>

informacionit, e cila mund të konsiderohet si një dobësi në zbatimin praktik të masave të transparencës. Prania e informacionit të pasaktë ose të paunifikuar bie ndesh me parimet e qartësisë dhe aksesueshmërisë që synon të garantojë Plani i Integritetit.

Në këtë kuadër, vlerësimi i monitorimit evidenton nevojën për një proces të qartë dhe të vazhdueshëm të përditësimit dhe standardizimit të informacionit të publikuar, duke siguruar që të ekzistojë një burim i vetëm zyrtar, i saktë dhe i konsoliduar për kontaktet dhe funksionin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Një qasje e tillë do të kontribuonte në rritjen e besueshmërisë së informacionit dhe në përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbimet informuese.

Nga ana tjetër, analiza e faqes zyrtare të **Bashkisë Shijak** tregon se bashkia ka të publikuar informacion mbi Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, si dhe mbi procedurat për paraqitjen e kërkesave për informacion²⁰. Kjo përbën një bazë të rëndësishme për garantimin e transparencës dhe për funksionimin e mekanizmave të komunikimit me publikun.

Megjithatë, për të siguruar një akses efektiv dhe të qëndrueshëm në informacion, është e nevojshme që këto të dhëna të jenë të përditësuara rregullisht, të paraqitura në mënyrë të qartë dhe të unifikuar në të gjitha seksionet përkatëse të

20) Bashkia Shijak, "KërkesapërInformim," <https://www.shijak.gov.al/>

faqes. Mungesa e koherencës ose e përditësimit mund të krijojë paqartësi dhe të kufizojë përdorimin efektiv të këtij mekanizmi nga qytetarët.

Në tërësi, funksionimi efektiv i rolit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit nuk lidhet vetëm me ekzistencën formale të informacionit në faqe, por edhe me saktësinë, koherencën dhe aksesueshmërinë e tij, të cilat janë elemente thelbësore për garantimin e transparencës reale dhe për forcimin e besimit të publikut në institucion.

RAPORTI VJETOR PËR TRANSPARENCËN NË PROCESIN E VENDIMMARRJES NË BASHKINË PËRMET

Në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet evidentohet ekzistenca e një rubrike të dedikuar për “Raportin vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes”²¹, e cila përbën një instrument të rëndësishëm për pasqyrimin e nivelit të transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në aktivitetin institucional .

Nga analiza e përmbajtjes së kësaj rubrike, rezulton se raportet përmbajnë elementë tregues të rëndësishëm, si numri i akteve të konsultuara me publikun, numri i komenteve dhe rekomandimeve të paraqitura nga qytetarët apo grupet e interesit, si dhe informacion mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara në kuadër të konsultimit publik. Gjithashtu, janë të disponueshme lidhje referuese për raportet e viteve përkatëse, çka mundëson ndjekjen e vazhdueshme të këtij procesi në kohë.

21) Bashkia Përmet, “RaportiVjetorpërTransparencënnëProcesin e Vendimmarrjes,” <https://bashkiapermet.gov.al/>

Kjo praktikë është në përputhje me frymën dhe objektivat e Planit të Integritetit, i cili thekson rëndësinë e rritjes së transparencës, përfshirjes së qytetarëve dhe forcimit të llogaridhënies në proceset vendimmarrëse. Publikimi i këtyre raporteve kontribuon në krijimin e një kulture më të hapur institucionale dhe në rritjen e besimit të publikut ndaj bashkisë.

Megjithatë, përtej ekzistencës së këtyre raporteve, një element i rëndësishëm i vlerësimit lidhet me cilësinë dhe plotësinë e informacionit të ofruar, si dhe me nivelin e analizës së të dhënave të paraqitura. Në veçanti, është e rëndësishme që raportet të ofrojnë jo vetëm të dhëna sasiore, por edhe një analizë më të thelluar të rezultateve të konsultimeve publike dhe ndikimit të tyre në vendimmarrje.

Gjithashtu, vlerësimi i efektivitetit të këtij mekanizmi lidhet me rregullsinë e publikimit dhe përditësimit të raporteve, si dhe me aksesueshmërinë e tyre për qytetarët. Një paraqitje e qartë, e strukturuar dhe e lehtë për t'u naviguar rrit ndjeshëm përdorshmërinë e këtij informacioni dhe kontribuon në transparencë reale, jo vetëm formale.

Në tërësi, publikimi i Raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes përbën një praktikë pozitive të Bashkisë Përmet, megjithatë përmirësimi i cilësisë analitike dhe i vazhdimësisë së publikimeve mbetet një element i rëndësishëm për forcimin e mëtejshëm të llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare.

RAPORTI VJETOR PËR TRANSPARENCËN NË PROCESIN E VENDIMMARRJES NË BASHKINË SHIJAK

Nga analiza e faqes zyrtare të Bashkisë Shijak rezulton se bashkia publikon informacion që lidhet me transparencën në procesin e vendimmarrjes, duke përfshirë njoftime për konsultime publike, dokumente vendimmarrëse dhe elementë të komunikimit me qytetarët.

Megjithatë, në krahasim me një strukturë të plotë të raportimit vjetor, evidentohet nevoja për një organizim më të qartë dhe më të strukturuar të informacionit në formën e një raporti të konsoliduar për transparencën në procesin e vendimmarrjes. Një raport i tillë do të mundësonte një pasqyrë më të plotë dhe më të kuptueshme mbi nivelin e konsultimit publik, përfshirjen e qytetarëve dhe ndikimin e tyre në vendimmarrje.

Aktualisht, informacioni i publikuar është i shpërndarë në seksione të ndryshme të faqes dhe përfshin elementë të

rëndësishëm, si njoftime për konsultime publike dhe dokumente të miratuara, por mungon një përmbledhje analitike që të evidentojë në mënyrë të strukturuar tregues si numri i akteve të konsultuara, pjesëmarrja e qytetarëve, komentet apo rekomandimet e marra dhe ndikimi i tyre në vendimmarrje.

Nga këndvështrimi i integritetit institucional, mungesa e një raportimi të tillë të konsoliduar kufizon nivelin e llogaridhënies dhe vështirëson vlerësimin e efektivitetit të mekanizmave të konsultimit publik. Një raport vjetor i strukturuar do të kontribuonte në rritjen e transparencës, në përmirësimin e komunikimit me publikun dhe në forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucionit.

Në këtë kuadër, vlerësimi i monitorimit evidenton nevojën për hartimin dhe publikimin e një raporti të rregullt dhe të strukturuar për transparencën në procesin e vendimmarrjes, në përputhje me standardet e Programit të Transparencës dhe me objektivat e Planit të Integritetit. Një praktikë e tillë do të mundësonte jo vetëm raportimin formal, por edhe një analizë më të thelluar të përfshirjes së publikut dhe të cilësisë së proceseve vendimmarrëse.

REGJISTRA DHE DOKUMENTE TË RËNDËSISHME

Nga verifikimi i rubrikave të transparencës në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet rezulton se bashkia ka të publikuar nën-seksione të dedikuara për të drejtën e informimit, si “Kërkesë për informacion”, si dhe elementë të tjerë që lidhen me iniciativat qytetare dhe peticionet. Këto komponentë përbëjnë instrumente të rëndësishëm për garantimin e transparencës dhe për nxitjen e përfshirjes aktive të qytetarëve në jetën publike.

Prania e këyre rubrikave tregon një përpjekje për të krijuar kanale komunikimi ndërmjet bashkisë dhe publikut, duke i mundësuar qytetarëve jo vetëm akses në informacion, por edhe mundësi për të shprehur qëndrime, kërkesa apo shqetësime përmes mekanizmave të formalizuar. Në këtë drejtim, këto elemente janë në përputhje me objektivat e Planit të Integritetit, i cili synon rritjen e transparencës dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët.

Megjithatë, për një funksionim më efektiv të këtyre mekanizmave, është e rëndësishme që informacioni i publikuar të jetë i plotë, i përditësuar dhe i strukturuar në mënyrë

të qartë, në mënyrë që qytetarët të mund të përdorin lehtësisht këto instrumente. Gjithashtu, evidencimi i përdorimit të këtyre mekanizmave (p.sh. numri i kërkesave për informacion, trajtimi i peticioneve apo iniciativave qytetare) do të kontribuonte në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Nga ana tjetër, analiza e faqes zyrtare të Bashkisë Shijak tregon se bashkia publikon njoftime për konsultime publike dhe informacione që lidhen me proceset vendimmarrëse . Kjo përbën një bazë të rëndësishme për përfshirjen e qytetarëve në këto procese.

Megjithatë, evidentohet nevoja për përmirësim në drejtim të dokumentimit dhe publikimit të rezultateve të këtyre konsultimeve. Konkretisht, mungon një pasqyrë e strukturuar mbi komentet dhe rekomandimet e marra nga qytetarët, si dhe mbi mënyrën se si këto inpute janë reflektuar në vendimmarrje. Kjo kufizon nivelin e transparencës dhe e bën më të vështirë vlerësimin e ndikimit real të pjesëmarrjes publike.

Nga këndvështrimi i integritetit institucional, dokumentimi i plotë i ciklit të konsultimit publik – nga njoftimi deri te reflektimi i komenteve në vendimmarrje – është një element thelbësor për garantimin e llogaridhënies dhe besimit të publikut. Në këtë drejtim, përmirësimi i mënyrës së raportimit dhe publikimit të rezultateve të konsultimeve publike përbën një hap të rëndësishëm për forcimin e transparencës në Bashkinë Shijak.

Në tërësi, ndërsa të dy bashkitë kanë ngritur mekanizma bazë për informimin dhe përfshirjen e publikut, niveli i efektivitetit të tyre lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e dokumentimit, përditësimit dhe transparencës së informacionit të publikuar.

GJETJET E MONITORIMIT PËR BASHKINË PËRMET

Në këtë seksion paraqiten gjetjet kryesore të monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkia Përmet, të strukturuar sipas tre objektivave kryesorë të planit . Analiza mbështetet në shqyrtimin e synimit dhe logjikës së masave të parashikuara, në evidencën e disponueshme (publike ose të kërkueshme), në vlerësimin e statusit të zbatimit gjatë periudhës shtator–dhjetor, si dhe në identifikimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim.

Objekivi 1: Forcimi, menaxhimi efektiv dhe zhvillimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore

Ky objektivi konsiderohet themelor për integritetin institucional, pasi një pjesë e konsiderueshme e risqeve lidhen drejtpërdrejt me kapacitetet njerëzore dhe organizimin e brendshëm të administratës. Fenomene të tilla si vakancat e zgjatura, mbingarkesa e punës, mungesa e trajnimeve apo paqartësitë në role dhe përgjegjësi krijojnë kushte që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë dhe transparencën e vendimmarrjes.

Gjatë periudhës së monitorimit është evidentuar se një pjesë e masave të parashikuara në plan adresojnë pikërisht këto problematika, duke përfshirë rishikimin e strukturës organizative për funksione të posaçme, si konsultimi publik dhe informimi, përpjekjet për plotësimin e vakancave në njësitë funksionale, si dhe rritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve. Gjithashtu, është parashikuar përmirësimi i administrimit të informacionit në fushën e burimeve njerëzore, përfshirë digjitalizimin e dosjeve dhe krijimin e databazave përkatëse.

Nga analiza e evidencës publike, rezulton se ekzistojnë elementë që lidhen me transparencën në këtë fushë, si publikimi i rregulloreve të brendshme dhe informacioni mbi funksionet kyçe të administratës. Megjithatë, është konstatuar se këto mekanizma nuk janë gjithmonë të konsoliduara në praktikë. Një shembull konkret është mospërputhja e të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, e cila krijon paqartësi dhe tregon nevojën për standardizim të informacionit.

Në të njëjtën kohë, për komponentin e zhvillimit profesional, mungon evidenca e strukturuar që do të mundësonte një vlerësim të plotë të progresit, si plane vjetore trajnimesh, lista pjesëmarrësish apo dokumentim i tematikave të zhvilluara. Po ashtu, për digjitalizimin e dosjeve dhe administrimin e databazave kërkohet evidencë e brendshme ose publikim i politikave përkatëse për aksesin dhe sigurinë e të dhënave.

Në këtë kuadër, problematikat kryesore lidhen me mungesën e një prezantimi të qartë dhe të konsistent të roleve kyçe të transparencës, si dhe me nevojën për një dokumentim më sistematik të proceseve që lidhen me burimet njerëzore dhe transparencën në vendimmarrje. Për këtë arsye, rekomandohet forcimi i procedurave të brendshme për rekrutimin, promovimin dhe zhvillimin profesional, si dhe krijimi i një sistemi të strukturuar evidencash që të mbështesë monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të Planit të Integritetit.

Objektivi 2: Menaxhimi i riskut të integritetit për të gjithë bashkinë

Ky objektivi përfshin një gamë të gjerë fushash funksionale dhe përfaqëson dimensionin më kompleks të Planit të Integritetit, pasi lidhet me identifikimin dhe adresimin e risqeve në të gjithë veprimtarinë e bashkisë. Në fushën e menaxhimit financiar dhe planifikimit buxhetor, plani identifikon risqe të rëndësishme që lidhen me realizimin e të ardhurave, mungesën e databazave të sakta të aktiveve, koordinimin ndërsektorial dhe nevojën për gjurmueshmëri më të mirë të proceseve.

Nga verifikimi i burimeve publike rezulton se bashkia publikon dokumente që lidhen me buxhetin dhe vendimmarrjen ekonomiko-financiare, çka kontribuon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Megjithatë, për një vlerësim më të plotë të zbatimit të masave, kërkohet evidencë më e detajuar mbi funksionimin real të këtyre proceseve.

Në fushën e administrimit dhe menaxhimit të pronave, risqet lidhen kryesisht me inventarizimin e paplotë, mungesën e dokumentacionit të pronësisë dhe mungesën e sistemeve të strukturuara të informacionit. Ndërkohë që ekzistojnë elementë të transparencës në publikimin e informacionit, vlerësimi i progresit kërkon akses në evidencat administrative që dokumentojnë proceset konkrete të inventarizimit dhe menaxhimit të pronave.

Në aspektin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, plani paraqet masa për rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe përmirësimin e proceseve të konsultimit publik. Monitorimi tregon ekzistencën e njoftimeve dhe dokumenteve të konsultimit, por mbetet e rëndësishme që këto procese të shoqërohen me dokumentim të plotë të komenteve dhe të ndikimit të tyre në vendimarrje.

Gjithashtu, në fushën e shërbimeve publike dhe mbikëqyrjes së kontratave, evidentohet nevoja për vendosjen e indikatorëve të matshëm dhe metodologjive të qarta monitorimi, ndërsa në aspektin e arkivimit dhe administrimit të informacionit, kërkohet evidencë mbi zbatimin e masave që lidhen me përmirësimin e kushteve dhe digjitalizimin.

Në tërësi, monitorimi tregon se janë ndërmarrë hapa fillestarë për menaxhimin e risqeve të integritetit, por procesi nuk është ende i konsoliduar në të gjitha strukturat dhe kërkon forcim të koordinimit ndërsektorial dhe përmirësim të dokumentimit të proceseve.

Objektivi 3: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin

Ky objektivi lidhet me krijimin dhe përditësimin e një kuadri të qëndrueshëm rregullator që mbështet etikën, transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Gjatë periudhës së monitorimit është konstatuar se ekziston një bazë e rëndësishme rregullatore, e cila përfshin dispozita që lidhen me Kodin e Etikës, detyrimet e stafit, marrëdhëniet me publikun dhe mekanizmat e informimit.

Megjithatë, pavarësisht kësaj baze, sfidat lidhen me koherencën e publikimeve dhe përditësimin e rregullt të informacionit, si dhe me gjurmueshmërinë e zbatimit të rregullave në praktikë. Mungesa e evidencave të strukturuar, si regjistra funksionale, raporte periodike apo dokumentim i proceseve të brendshme, kufizon mundësinë për një vlerësim të plotë të efektivitetit të kuadrit rregullator.

Në këtë drejtim, monitorimi evidenton progres të pjesshëm në përditësimin e rregulloreve dhe procedurave, veçanërisht në lidhje me konfliktin e interesit dhe transparencën, por thekson nevojën për vijimësi dhe angazhim të qëndrueshëm institucional për zbatimin e tyre në praktikë.

Në tërësi, monitorimi për periudhën shtator–dhjetor evidenton se Bashkia Përmet ka ngritur instrumentet bazë të transparencës dhe kuadrit rregullator për integritetin institucional. Megjithatë, mbetet e nevojshme përmirësimi i standardizimit

dhe përditësimit të informacionit publik, krijimi i evidencave të strukturara për zbatimin e masave dhe forcimi i koordinimit ndërmjet strukturave për menaxhimin e risqeve të integritetit.

GJETJET E MONITORIMIT PËR BASHKINË SHIJAK

Në këtë seksion paraqiten gjetjet e monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Shijak, të strukturuar sipas objektivave kryesorë të planit . Analiza mbështetet në përmbajtjen e Planit të Integritetit 2022–2025, në evidencat publike të disponueshme, në logjikën e zbatimit të masave gjatë periudhës së monitorimit, si dhe në nevojën për konsolidim institucional të mekanizmave të integritetit.

Objektivi 1: Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit të pronave dhe planifikimit të territorit

Menaxhimi i pronave bashkiake dhe planifikimi i territorit përfaqësojnë një nga fushat më të ndjeshme ndaj risqeve të integritetit, për shkak të vlerës së lartë ekonomike të aseteve, kompleksitetit të kuadrit ligjor dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me aktorë privatë. Plani i Integritetit i Bashkisë Shijak identifikon problematika që lidhen me inventarizimin e paplotë të pronave, mungesën e databazave elektronike funksionale,

vonesat në proceset e hipotekimit, si dhe nevojën për rritjen e transparencës në proceset e planifikimit territorial.

Gjatë periudhës së monitorimit, masat e parashikuara për këtë objektiv rezultojnë kryesisht në fazë zbatimi të pjesshëm ose në proces, duke reflektuar karakterin afatmesëm dhe kompleks të ndërhyrjeve në këtë fushë. Janë evidentuar përpjekje për përmirësimin e organizimit të brendshëm dhe për rritjen e koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse, si dhe për adresimin e problematikave të trashëguara në administrimin e pronave.

Nga pikëpamja e transparencës publike, konstatohet ekzistenca e njoftimeve dhe dokumenteve që lidhen me proceset e planifikimit territorial dhe konsultimet publike. Megjithatë, dokumentimi i plotë i rezultateve të këtyre proceseve, përfshirë reflektimin e komenteve të qytetarëve në vendimmarrje, kërkon përmirësim. Në tërësi, masat që lidhen me inventarizimin dhe administrimin e pronave mbeten në proces dhe kërkojnë evidenca administrative të strukturuar për të vlerësuar progresin real, ndërsa proceset e planifikimit territorial, megjithëse të formalizuara, kërkojnë rritje të transparencës në aspektin e rezultateve dhe ndikimit të konsultimeve publike.

Objektivi 2: Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut të integritetit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit

Ky objektivi synon forcimin e integritetit në menaxhimin financiar përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor, rritjes së kontrollit të brendshëm, transparencës në prokurime dhe forcimit të kapaciteteve audituese. Risqet e identifikuara lidhen kryesisht me realizimin e të ardhurave, menaxhimin e prokurimeve publike, mungesën e strukturave të dedikuara dhe nevojën për gjurmueshmëri më të mirë të vendimmarrjes financiare.

Gjatë periudhës shtator–dhjetor, monitorimi tregon se Bashkia Shijak ka ndërmarrë hapa në drejtim të publikimit të dokumenteve bazë financiare dhe vendimmarrëse, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e masave të Planit të Integritetit kërkojnë konsolidim të mëtejshëm, veçanërisht në drejtim të strukturimit të proceseve të kontrollit të brendshëm dhe dokumentimit të praktikave financiare.

Në këtë kuadër, vlerësimi i statusit tregon se mekanizmat bazë të transparencës financiare janë të pranishëm, por zbatimi i masave për menaxhimin e riskut financiar mbetet i pjesshëm dhe kërkon vijimësi, përmirësim të koordinimit ndërmjet strukturave dhe rritje të nivelit të dokumentimit të proceseve.

Objektivi 3: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspektet e veçanta të etikës dhe integritetit

Kuadri rregullator për etikën dhe integritetin përbën bazën normative për parandalimin e konflikteve të interesit, sjelljes joetike dhe praktikave jo transparente. Plani i Integritetit i Bashkisë Shijak parashikon një sërë masash që synojnë përditësimin dhe përmirësimin e rregulloreve të brendshme, procedurave standarde të veprimit dhe mekanizmave të kontrollit.

Monitorimi evidenton se ekziston një bazë rregullatore e konsoliduar, e cila përfshin elementë të rëndësishëm që lidhen me etikën dhe transparencën. Megjithatë, sfidat kryesore lidhen me zbatimin praktik dhe përditësimin periodik të këtij kuadri, si dhe me nivelin e ndërgjegjësimit të stafit për detyrimet që rrjedhin nga këto rregulla. Në këtë drejtim, nevojitet një dokumentim më i qartë i zbatimit të rregullave dhe një angazhim më i qëndrueshëm institucional për monitorimin e tyre.

Objektivi 4: Forcimi i integritetit institucional përmes burimeve njerëzore dhe përmirësimit të shërbimeve publike

Plani i Integritetit i Bashkisë Shijak i kushton rëndësi të veçantë rolit të burimeve njerëzore si faktor kyç për garantimin e integritetit institucional dhe për zbatimin efektiv të masave të parashikuara. Në këtë kuadër, zhvillimi i kapac-

iteteve, organizimi i brendshëm dhe cilësia e shërbimeve publike janë elementë të ndërlidhur.

Gjatë periudhës së monitorimit janë evidentuar përpjekje për përmirësimin e organizimit të brendshëm dhe rritjen e kapaciteteve të stafit. Megjithatë, mungesa e planeve të strukturuar të trajnimit dhe nevoja për një sistem më të qartë të vlerësimit të performancës mbeten sfida kryesore. Kjo ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe në cilësinë e shërbimeve që i ofrohen qytetarëve.

Objekti 5: Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës

Transparenca dhe llogaridhënia publike përbëjnë mekanizma thelbësorë për rritjen e besimit të qytetarëve dhe për parandalimin e korrupsionit. Plani i Integritetit parashikon masa për përmirësimin e informimit publik, forcimin e konsultimit me qytetarët dhe publikimin e dokumenteve kyçe në faqen zyrtare të bashkisë.

Monitorimi tregon se ekzistojnë instrumentet bazë të transparencës dhe komunikimit publik, përfshirë publikimin e dokumenteve dhe njoftimeve për konsultime. Megjithatë, sfidat lidhen me nivelin e dokumentimit të proceseve dhe me përditësimin e vazhdueshëm të informacionit, si dhe me nevojën për një paraqitje më të strukturuar dhe më të qartë të rezultateve të konsultimeve publike dhe ndikimit të tyre në vendimmarrje.

Në tërësi, monitorimi për Bashkinë Shijak evidenton ekzistencën e instrumenteve bazë të integritetit dhe transparencës, si dhe një progres të moderuar në zbatimin e masave të Planit të Integritetit. Megjithatë, mbetet e nevojshme përmirësimi i dokumentimit të proceseve, forcimi i koordinimit ndërsektorial dhe vijimi i monitorimit periodik, me qëllim konsolidimin e mekanizmave të integritetit dhe rritjen e efektivitetit të tyre në praktikë.

KONKLUZIONE

Monitorimi i zbatimit të Planeve të Integritetit për vitin 2025 tregon se si Bashkitë Përmet ashtu edhe Shijak kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të forcimit të integritetit institucional. Megjithatë, niveli i progresit dhe shkalla e konsolidimit të masave paraqiten të ndryshme.

Në rastin e Bashkisë Përmet, evidentohet një progres i moderuar në zbatimin e Planit të Integritetit, i reflektuar në ngritjen e mekanizmave bazë të transparencës dhe në përfshirjen e strukturave administrative në procesin e zbatimit. Angazhimi institucional është i dukshëm, megjithatë zbatimi i plotë i një pjese të masave mbetet i kushtëzuar nga kapacitetet organizative, burimet njerëzore dhe nevoja për dokumentim më të strukturuar të proceseve. Në këtë kuadër, Plani i Integritetit vijon të mbetet një instrument i rëndësishëm për parandalimin e risqeve dhe për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor, por kërkon konsolidim të mëtejshëm në praktikë.

Nga ana tjetër, Bashkia Shijak ka bërë përpertime të rëndësishme në ndërtimin e një kuadri institucional për integritetin, duke reflektuar një angazhim për zhvillimin e mekanizmave të

transparencës dhe të menaxhimit të riskut. Monitorimi tregon se janë ndërmarrë hapa konkretë për publikimin e informacionit dhe dokumenteve zyrtare, duke krijuar një bazë funksionale për aksesin e publikut në informacion. Megjithatë, sfidat kryesore lidhen me cilësinë dhe koherencën e informacionit të publikuar, si dhe me dokumentimin e plotë të proceseve, veçanërisht në lidhje me rezultatet e konsultimeve publike dhe reflektimin e tyre në vendimmarrje.

Në tërësi, për të dy bashkitë mbetet e nevojshme një qasje më e qëndrueshme dhe sistematike në zbatimin e Planeve të Integritetit, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve administrative, përmirësimin e koordinimit ndërsektorial dhe rritjen e cilësisë së dokumentimit dhe transparencës. Kjo do të mundësonte kalimin nga një nivel formal i zbatimit drejt një sistemi më të konsoliduar dhe efektiv të integritetit institucional, duke kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve dhe në përmirësimin e qeverisjes vendore.

REKOMANDIME

Në bazë të gjetjeve të monitorimit për vitin 2025, rekomandohet ndërmarrja e një sërë masash për përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të Planit të Integritetit dhe forcimin e qeverisjes vendore.

Në drejtim të qeverisjes dhe koordinimit institucional, është e nevojshme të përcaktohet qartësisht një strukturë ose koordinator përgjegjës për ndjekjen e Planit të Integritetit, i cili të ketë rol aktiv në mbledhjen e evidencave, koordinimin ndërsektorial dhe raportimin periodik të progresit. Paralelisht, rekomandohet krijimi i një kalendari të brendshëm raportimi, si praktikë e rregullt institucionale, ku çdo drejtori ose strukturë të raportojë mbi masat që ka në përgjegjësi, duke garantuar kështu një ndjekje më sistematike të zbatimit të planit.

Në aspektin e transparencës dhe të drejtës për informim, mbetet thelbësore unifikimi dhe përditësimi i informacionit të publikuar për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, duke eliminuar çdo mospërputhje dhe duke garantuar ekzistencën e një burimi të vetëm zyrtar dhe të saktë për kontaktet dhe funksionin e tij.

Gjithashtu, rekomandohet publikimi dhe përditësimi i rregullt i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, si dhe paraqitja e qartë dhe e aksesueshme e tarifave, afateve dhe procedurave për qytetarët.

Njëkohësisht, është e rëndësishme rritja e gjurmueshmërisë së proceseve të konsultimit publik, duke publikuar jo vetëm njoftimet, por edhe përmbledhjen e komenteve të marra, mënyrën e trajtimit të tyre dhe arsyetimin për vendimmarrjen përkatëse.

Në lidhje me etikën dhe konfliktin e interesit, rekomandohet forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe i zbatimit praktik të tij, veçanërisht në aspektet që lidhen me konfliktin e interesit, regjistrat përkatës dhe menaxhimin e dhuratave. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm luan edhe rritja e ndërgjegjësimit të stafit përmes organizimit të trajnimeve të brendshme periodike mbi etikën, integritetin dhe detyrimet për deklaram.

Për sa i përket menaxhimit të riskut dhe mekanizmave të kontrollit, është e nevojshme konsolidimi i një qasjeje të unifikuar të menaxhimit të riskut në të gjitha fushat funksionale, e mbështetur në një metodologji të përbashkët dhe në kontribute periodike nga njësitë përkatëse. Gjithashtu, rekomandohet forcimi i dokumentimit të proceseve administrative, përfshirë procedurat standarde të veprimit, gjurmët e auditimit dhe dokumentimin e vendimmarrjes, si dhe publikimi i dokumenteve kyçe kur kjo është e përshtatshme për rritjen e transparencës.

Në aspektin e arkivës dhe digjitalizimit, rekomandohet vlerësimi i kushteve fizike të ruajtjes së dokumentacionit dhe planifikimi gradual i digjitalizimit, me prioritet për dokumentet financiare, pronësore dhe ato që kërkohen më shpesh nga publiku, në mënyrë që të rritet siguria dhe aksesueshmëria e informacionit.

Në tërësi, rekomandohet vijimi i monitorimit periodik dhe përdorimi i gjetjeve të këtij raporti si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve institucionale, me qëllim forcimin e integritetit, transparencës dhe cilësisë së qeverisjes vendore.

BIBLIOGRAFIA

- Bashkia Përmet. Plani i Integritetit 2022–2025. Përmet: Bashkia Përmet, 2022.
- Bashkia Shijak. Plani i Integritetit 2022–2025. Shijak: Bashkia Shijak, 2022.
- Control and Evaluation Democracy Institute (CEDI). Materiale dhe Raporte mbi Integritetin dhe Transparencën në Nivel Vendor.
- Këshilli i Ministrave. Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë. Tiranë: Këshilli i Ministrave.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Udhëzime dhe Akte Nënligjore për Zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit.
- Kuvendi i Shqipërisë. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë, 2015.

- Kuvendi i Shqipërisë. Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë, 2014.
- Kuvendi i Shqipërisë. Ligji nr. 9367/2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” (i ndryshuar). Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë, 2005.
- Kuvendi i Shqipërisë. Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë, 2015.
- Ministria e Drejtësisë. Metodologjia për Hartimin dhe Monitorimin e Planeve të Integritetit në Institucionet Publike. Tiranë: Ministria e Drejtësisë, 2019.
- Ministria e Drejtësisë. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015–2023 (e Përditësuar). Tiranë: Ministria e Drejtësisë, 2021.

